

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar i kolegjit, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses A. R.-M., nga ..., të cilën me autorizim e përfaqëson Xh. R.,av.nga ...,kundër të paditurës Ndërmarrja Hidroekonomike “Ibër Lepenc” sh.a.me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Drita Bilalli, objekti i kontestit anulimi i vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kthimi në punë si dhe kompensimi i të ardhurave personale, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4206/15 datë 12.2.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.6.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4206/15 datë 12.2.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4206/15 datë 12.2.2018 nën pikën I të dispozitivit është refuzuar ankesa e të paditurës në pjesën e aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm C.nr.2708/09 datë 1.7.2015 dhe atë nën pikën I të dispozitivit me të cilën është anuluar vendimi i të paditurës 01-266 i datës 15.9.2006 si i kundërligjshëm dhe është detyruar e paditura që paditësen ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës dhe në këtë pjesë aktgjykimi vërtetohet.

Nën pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i shkallës së parë është prishur në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e të ardhurave personale si dhe pagimin në emër të kontributit pension, tatimit në pagë dhe shpenzimet e procedurës, dhe aktgjykimi në fjalë i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Kundër aktgjykimit të goditur, e paditura ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të dy aktgjykimet, sa i përket pjesës aprovuese, të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditëses ose e njëjta të prishet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Paditësja nuk ka dhënë përgjigje në revizion të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të aktgjykimit të goditur në bazë të nenit 215 të LPK-së, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje nga neni 215 të LPK-së për ekzistimin e të cilave gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar se paditësja te e paditura ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të caktuar dhe atë prej 01.04.2009 e deri më 12.10.2009, në bazë të kontratës së punës me nr. ..., të datës ..., dhe atë në detyrat e punës ..., Pas vlerësimit të performancës së paditëses nga ana e menaxherit të paditurës, është lidhur kontrata e punës me nr. ..., të datës ..., për kryerjen e detyrave të njëjta të punës, por me kohëzgjatje të kontratës së punës për kohë të pacaktuar. Pas kësaj Krye shefi Ekzekutiv i të paditurës me vendimin e saj me nr. ..., të datës ..., e shfuqizon, kontratën e punës së paditëses të datës 31.08.2009 dhe e lenë në fuqi kontratën e parë të punës të datës 12.03.2009 e cila ka qenë në kohë të caktuar dhe me këtë paditëses ndëprehet marrëdhënia e punës. Paditësja ka kundërshtuar vendimin në fjalë, ndërsa e paditura nuk ka vendosur lidhur me kundërshtimin e paditëses.

Gjykata e shkallës së parë vlerëson si të kundërligjshëm vendimi e të paditurës mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditëses duke detyruara që e paditura të kthej në punë paditësen në

detyrat e punës që e ka kryer sipas kontratës së punës si dhe të kompensoj të ardhurat personale për periodën kontestuese .

Gjykata e apelit të Kosovës duke vendosur sipas ankesës së paditurës,të njëjtin pjesërisht ka pranuar , ashtu që vendimin e gjykatës së shkallës sa i përket pushimit të marrëdhënies së punës së paditëses në këtë pjesë aktgjykimin shkallës së parë vërteton, duke pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë. Sa i përket kompensimit të ardhurave personale të paditëses ,gjykata e shkallës së dytë në këtë pjesë ,pranon ankesën e paditurës dhe lëndën e kthen në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate ,gjykata e shkallës së dytë drejt ka vepruar kur ka refuzuar ankesën e të paditurës në pjesën sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të paditurës për shkëputjen e kontratës së punës së paditëses, pasi që paditëses i është ndërprerë kontrata e punës në kundërshtim me nenin 113 dhe nenin 11 të Ligjit themelor të punës, dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditëses është arbitrare duke mos dhënë mundësi paditëses as mbrojtje drejtave të saja nga marrëdhënia e punës. Sipas nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*,kjo paditëses nuk është dhënë mundësia. E që në bazë të nenit 31 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës *“ Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”* ,ndërsa sipas nenit 49 të kësaj kushtetute e drejta punës garantohet. Nga vetë fakti se paditëses i është mohuar e drejta për mbrojtje interne të drejtave të saja nga marrëdhënia e punës ,të njëjtës nuk mund mohohet e drejta për mbrojtje gjyqësore që garantohet e dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut .

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se paditësja në bazë të konkursit të punës ka lidhur marrëdhënie pune në kohë të caktuar , nga arsyeja se paditëses me kontratën e datës .31.08.2009 , paditësja ka lidhur kontratë të punës në kohë të pacaktuar dhe se kjo kontratë është lidhur me personin e pa autorizuar të paditurës dhe atë kohën sa ka patuar mandatin dhe se shfuqizimi i kontratës së dytë është bërë në mënyrë arbitrare pa mbështetje në ligj, prandaj edhe thëniet e revizionit janë të pabazuara .Një herit paditëses nuk është afruar as mbrojtje interne

na e paditura për të realizuar të drejta nga marrëdhënia e punës ashtu të njëjtës ,nuk mund të mohohet e drejta për mbrojtje gjyqësore .

Pretendimet e revizionit sa i përket gjendjes faktike nga gjykata e revizionit nuk janë vlerësuar, për shkak se revizioni nuk mund të paraqitet për shkak konstatimit të gabuar të gjendjes të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe atë sipas nenit 214.2 të LPK.

Nga arsyet e dhëna më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit në bazë të nenit 222 të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.160/2018 datë 18.6.201

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri